



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 194/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Laziç dhe Afijete Sada - Glllogjani anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Agron Istrefit nga Prishtina, paraqitur kundër Behxhet Pacollit - kryetar i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në pronë private, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 12.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Agron Istrefit nga Prishtina, Anr.194/2017 e datës 11.06.2017, paraqitur kundër Behxhet Pacollit - kryetar i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11 qershor 2017, nga Agron Istrefi në Prishtinë, paraqitur kundër Behxhet Pacollit - kryetar i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AKR ka vendosur fotografimin e kryetarit të tyre Behxhet Pacolli, pa lejen e banorëve të ndërtesës, duke theksuar se kjo përbën shkelje zgjedhore dhe se e njëjta po përsëritet në çdo palë zgjedhje. Me propozim që ankesa të parovohet si e bazuar dhe të largohet posterit në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë i datës 12.06.2017 subjekti politik AKR, ka theksuar se në mbështetje të LZP-së fotografit lejohen që të vendosen në hapsira private, sepse kjo hapsirë është e privatizuar nga kompania "MABETEX" dhe lidhur me vendosjen e kësaj fotografie të kryetarit nga radhët e subjektit të tyre, është vendosur pas marrjes së lejes nga kompania në fjalë, pastaj është vendosur, dhe se kati i tretë i kësaj ndërtese që është vendosur një pjesë e fotografisë është pronë private.

Në cilësinë e provës përgjigjes i ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi për evitimin e shkeljes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 i LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nuk janë identifikuar se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar respektivisht kur është vendosur posteri në fjalë sepse nga kjo varet rrjedhja e afatit të parashtrimit të ankesës ngase ky afat është 24 orë nga shkelja e supozuar e që në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk e ka dëshmuar se shkelja ka ndodhur brenda afati 24 orë nga momenti i parashtrimit të ankesës.

Për më tepër parashtruesi i ankesës nuk e ka dëshmuar me prova se i njëjti është pronar i hapësirës i pjesës ndërtesës, se ku ka ndodhur shkelja.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr.194/2017 i datës 12.06.2017



Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 i LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.